



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1857/5Prot

Datë 24.07.2024

V E N D I M
Nr. 955/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 24.07.2024 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

“Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Infosoft Office” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A.

Modifikimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-07-2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Sarandë SH.A.

Ankimues:

Operatori ekonomik “Infosoft Office” SHPK, me Nipt (J62426002Q), me adresë: Autostrada Tiranë – Durrës, Km 8, Tiranë.

Operatori ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, me Nipt (L82428011G), me adresë: Njesia Administrative nr. 10, Rruga "Fortuzi", Nr. 66/.

Autoriteti Kontraktor:

Shoqëria Rajonale Ujësjetës Kanalizime Sarandë SH.A, me adresë: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd.1, 1001, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik pasi shqyrtoi ankesat e paraqitura nga operatorët ekonomikë ankimues dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatorët ekonomikë ankimues, kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 05.07.2024, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16-07-2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Sarandë SH.A.

II.2. Në datën 10.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2024/4316 dhe nr. 1889 prot., i operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt – ankimi.

II.2.1. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.2.2. Me anë të shkresës nr. 620 prot., datë 16.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1889/2 prot., datë 18.07.2024, me objekt “Dërgim vendimi për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...]Ne DST ishte kërkuar : 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues per mallrat objekt prokurimi duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve ose skedat teknike te mallrave objekt prokurimi, me gillim vertetimin e permbushjes se specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet te permbaje karakteristikat teknike te do artikulli sipas kerkesave te DST me qellim qe autoriteti kontraktor te giykojë nëse malli i ofruar ploteson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentet e tenderit. Per produktet e thjeshta per te cilat nuk mund te sigurohen kataloge ose skeda teknike jafton te paraqiten mostrat sipas parashikimeve ne piken 2.3.4 dhe ky kriter do te konsiderohet i permbushur. Argumentimi: Ky kriter ishte menduar per ti dhine sigurine AK që OE ofertues do te paraqesë mallra, te cilët permbushin kerkesat e specifikimeve teknike dhe janë ne perputhje me to. Kriteri i kerkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, este vendosur ne perputhje me piken 6/b, te Nenit 40, të VKM Nr. 285, date 19.05.2021 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik".

• Kërkesa pranohet, dhe behet ndryshimi si me poshte : 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues per mallrat objekt prokurimi te cilat jane me perdorim me te larte ne institucion, artikujt e kancelarise te kerkuar nga AK-ja, ne sasi te barabarte ose më larte se 500 cope duhet te paraqese katalogun/et ose fragmente te katalogut/eve ose skedat teknike te mallrave ose mostra te tyre, me qellim vertetimin e permbushjes se specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike ose mostra duhet te permbaje karakteristikat teknike te do artikulli sipas

kerkesave te DST me qellim qe autoriteti kontraktor te giykoje nese malli i ofruar plotëson kerkesat teknike te percaktuara ne dokumentet e tenderit.

*2.3 Kapaciteti teknik 1. Në shtojcen nr.6 nuk eshte percaktuar grafiku/afati i levrimit. Ju lutemi te percaktohet afati/grafiku levrimit. Nisur nga sasia e produkteve, vleresojme se nje afat 15 ditor eshte mese i mjaftueshem per te realizuar proceduren, duke patur parasysh qe procedura zhvillohet ne mes te sezonit veror, ku nje pjese e stafit marrin lejen e zakonshme. • **Kerkesa pranohet, afati i levrimit te mallit do te ndryshoje dhe do behet 10 dite, me argumentimin se shte nje afat i mjaftueshem per paraqitjen e ketyre mallrave, kancelari dhe bojera printeri.**

*2. Tonerat te kene afat skadence jo me pak se nje vit nga momenti i levrimit te mallit, (ne momentin e dorezimit te mallit tek autoritetit kontraktor, malli te shoqerohet me certifikatin e garancise).

• **Kërkesa pranohet, dhe behet ndryshimi si me poste:** Tonerat duhet te jenë te reja, te papërdorura, te ambalazhuara ne kuti dhe te plotesojne te githe elementet e sigurise, ne rastet kur aplikohen nga prodhuesi.

*Specifikimet teknike: 1. Nr.56 (Gome fshirese e bardhe): Game universale per fshirje lapsi dhe boje. Te jete e bere nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te shire dhe jollat me te theksuara te lapsit dhe bojës. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit.

• **Kerkesa pranohet dhe do te behet ndryshimi si me poshte :** (Gome shirese e bardhe): Game universale per fshirje lapsi dhe boje. Te jete e berë nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te fshire dhe jollat me te theksuara te lapsit dhe bojës. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit.

*Nr.26 (Blloqe shenimi tavoline me ngiyra 500 flete me ngjites): Blloqe me ngjitje 75mm#5mm x 75mm#5mm me 50 flete me ngiyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj- 150 cope;

- **Kerkesa pranohet dhe do te behet ndryshimi si me poshte :** Blloqe me ngjitje 75mm#5mm x 75mm5mm me 500 flete me ngiyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rëndesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te vshtira. Ato mund te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj.

**Nr. 27 (Blloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete): Blloqe me ngjitje 75mm#5mm x 75mm#5mm me 50 flete me ngiyra tendryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj - 180cope;

• **Kerkesa pranohet dhe do te bëhet dryshimi si me poshte :** (Blloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete): Blloqe me ngjitje 75mm x 75mm me 100 flete me ngiyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerr ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mund te perdoren per te shenuar lajmerime,shënime etj - 180 copë.

**4. Nr.35 (USB 16 GB): USB- 70 copë;

• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi nga UPS ne USB.**

** Nr.47 (Kapse me vesh (binder clips) te medha 10cope/pako): Ndertimi i produktit te jete i forte dhe i qëndrueshem qe lejon te kapen shume faqe se bashku per organizimin perfundimtar te dokumentave. Paketimi jo me pak se 12 copë- 30 pako;

• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte ;** Kapse me veshe 51 mm, kutia me nga 12 cope, metalike, e forte dhe me konstrukt te ndrueshem. E pershtatshme per te kapur disa flete bashke per nje organizim me te mire te dokumenteve.

*** Nr.56 (Dosje konferenciale magnetike A5 zeze): Dosje konferenciale magnetike A5 zeze-15 cope;*

*• **Kërkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte ; (Dosje konferenciale magnetike A5 zeze): Dosje Konferencash me kapak, me veshje lekure, kapese te forte metalike, me xhеп te brendshem dhe me mbajtese stilolapsi, te zeze. 7.***

***Nr. 69 (Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm): Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm-20 cope;*

*• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte ; (Flamur me thek (institucioni) 90x140 cm): Flamur me thek (institucioni) 90x140 cm-20 copë;***

***Nr.14 (Printer Samsung Xpress M20236) - 3 cope;*

*• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte : (Printer Samsung Xpress M2036)-3 cope [...]***

II.3. Në datën 08.07.2024, nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr.A/2024/43207 dhe nr. 1857 prot., i operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi.

II.3.1. Bazuar në nenin 112, pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.3.2. Me anë të shkresës nr. 616 prot., datë 15.07.2024, protokolluar me tonën me nr. 1857/2 prot., datë 17.07.2024, me objekt “Dërgim vendimi per procedurën e prokurimit me objekt “Blrje kancelari dhe bojra printeri””, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

*[...]*2.3 Kapaciteti teknik 1. Ne shtojcen nr.6 nuk eshte percaktuar grafiku/afati i levrimit. Ju lutemi te percaktohet afati/grafiku levrimit. Nisur nga sasia e produkteve, vleresome se nje afat 15ditor eshte mese I mjaftueshem per te realizuar proceduren, duke patur parasysh qe procedura zhvillohet ne mes te sezonit veror, ku nje pjese e stafit marrin lejen e zakonshme.*

*• **Kerkesa pranohet, afati i levrimit te mallit do te ndryshoje dhe do bëhet 10 dite, me argumentimin se eshte nje afat i mjaftueshem per paragitjen e ketyre mallrave, kancelari dhe bojera printeri.***

**. Tonerat te kene afat skadence jo me pak se nje vit nga momenti i levrimit te mallit, (në momentin e dorezimit te mallit tek autoritetit kontraktor, malli te shoqerohet me certifikatin e garancise).*

*• **Kerkesa pranohet, dhe behet ndryshimi si me poshte : • Tonerat duhet te jene te reja, te paperdorura, te ambaiazhuara ne kuti dhe të plotesone te gjithe elementet e sigurise, ne rastet kur aplikohen nga prodhuesi.***

***Artikulli nr.21 Color LazerJet Pro M254dë eshte printer me ngiyre, me 4 tonera. Njësia e vendosur nga AK ishte Cope 1. Ju lutemi specifikoni se cilën ngiyre doni te prokuroni.*

*• **Kjo kerkesë pranohet, artikulli nr.21 Color LazerJet Pro M254dë eshte printer me kater ngjyra,te katerta ngjyrat.[...]***

III

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesve për modifikimin e dokumenteve të tenderit, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me anë të shkresës nr. 620 prot., datë 16.07.2024 protokolluar me tonën me nr. 1889/2 prot., datë 18.07.2024, me objekt “Dërgim vendimi për procedurën e prokurimit me objekt “Blirje kancelari dhe bojra printeri””, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

“[...]Ne DST ishte kërkuar : 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me gillim vertetimin e permbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të do artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të percaktuara në dokumentet e tenderit. Për produktet e thjeshta për të cilat nuk mund të sigurohen katalogje ose skeda teknike jafton të paraqiten mostrat sipas parashikimeve në piken 2.3.4 dhe ky kriter do të konsiderohet i përmbushur. Argumentimi: Ky kriter ishte menduar për të dhënë siguri AK që OE ofertues do të paraqesë mallra, të cilët përmbushin kërkesat e specifikimeve teknike dhe janë në përputhje me to. Kriteri i kërkuar në lidhje me katalogun e prodhuesit/prodhuesve, është vendosur në përputhje me piken 6/b, të Nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

• Kërkesa pranohet, dhe behet ndryshimi si më poshtë : 2.3.3. Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi të cilat janë me përdorim me të lartë në institucion, artikujt e kancelarisë të kërkuar nga AK-ja, në sasi të barabartë ose më lartë se 500 cope duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave ose mostra të tyre, me qëllim vertetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike ose mostra duhet të përmbajë karakteristikat teknike të do artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të percaktuara në dokumentet e tenderit.

**2.3 Kapaciteti teknik 1. Në shtojcën nr. 6 nuk është percaktuar grafiku/afati i levrimit. Ju lutemi të percaktohet afati/grafiku i levrimit. Nisur nga sasia e produkteve, vlerësojmë se një afat 15 ditësh është më i mjaftueshëm për të realizuar procedurën, duke patur parasysh se procedura zhvillohet në mes të sezonit veror, ku një pjesë e stafit marrin lejen e zakonshme. • Kërkesa pranohet, afati i levrimit të mallit do të ndryshojë dhe do të behet 10 ditë, me argumentimin se shtet një afat i mjaftueshëm për paraqitjen e ketyre mallrave, kancelari dhe bojera printeri.*

**2. Tonerat të kënaqur afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i levrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoriteti kontraktor, malli të shogërohet me certifikatin e garancisë).*

• **Kërkesa pranohet, dhe behet ndryshimi si me poste:** Tonerat duhet te jenë te reja, te papërdorura, te ambalazhuara ne kuti dhe te plotesojne te githe elementet e sigurise, ne rastet kur aplikohen nga prodhuesi.

*Specifikimet teknike: 1. Nr.24 (Gome fshirese e bardhe): Game universale per fshirje lapsi dhe boje. Te jete e bere nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te fshire dhe njollat me te theksuara te lapsit dhe bojës. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit.

• **Kerkesa pranohet dhe do te behet ndryshimi si me poshte:** (Gome shirese e bardhe): Game universale per fshirje lapsi dhe boje. Te jete e berë nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te fshire dhe njollat me te theksuara te lapsit dhe bojës. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit.

*Nr.26 (Blloqe shenimi tavoline me ngiyra 500 flete me ngjites): Blloqe me ngjitje 75mm#5mm x 75mm#5mm me 50 flete me ngiyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mund te perdoren per te shenuar lajmerime, shenime etj- 150 cope;

- **Kerkesa pranohet dhe do te behet ndryshimi si me poshte:** Blloqe me ngjitje 75mm#5mm x 75mm5mm me 500 flete me ngiyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rëndesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te vshtira. Ato mund te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj.

**Nr. 27 (Blloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete): Blloqe me ngjitje 75mm#5mm x 75mm#5mm me 50 flete me ngiyra tendryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj - 180cope;

• **Kerkesa pranohet dhe do te bëhet ndryshimi si me poshte:** (Blloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete): Blloqe me ngjitje 75mm x 75mm me 100 flete me ngiyra te ndryshme. Letrat ngjites shërbejne per te nxjerr ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mund te perdoren per te shenuar lajmerime,shënime etj - 180 copë.

**4. Nr.35 (USB 16 GB): USB- 70 copë;

• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi nga UPS ne USB.**

** Nr.47 (Kapse me vesh (binder clips) te medha 10cope/pako): Ndertimi i produktit te jete i forte dhe i qëndrueshem që lejon te kapen shume faqe se bashku per organizimin perfundimtar te dokumentwve. Paketimi jo me pak se 12 copë- 30 pako;

• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte;** Kapse me veshe 51 mm, kutia me nga 12 cope, metalike, e forte dhe me konstrukt te qëndrueshem. E pershtatshme per te kapur disa flete bashke per nje organizim me te mire te dokumenteve.

** Nr.56 (Dosje konferenciale magnetike A5 zeze): Dosje konferenciale magnetike A5 zeze- 15 cope;

• **Kërkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte;** (Dosje konferenciale magnetike A5 zeze): Dosje Konferencash me kapak, me veshje lekure, kapesë te forte metalike, me xhëp te brendshem dhe me mbajtëse stilolapsi, te zeze. 7.

**Nr. 69 (Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm): Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm-20 cope;

• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte ;** (Flamur me thek (institucioni) 90x140 cm): Flamur me thek (institucioni) 90x140 cm-20 copë;

**Nr.14 (Printer Samsung Xpress M20236) - 3 cope;

• **Kerkesa pranohet, dhe do behet ndryshimi si me poshte :** (Printer Samsung Xpress M2036)- 3 cope [...]

III.1.2. Me anë të shkresës nr. 616 prot., datë 15.07.2024 , protokolluar me tonën me nr. 1857/2 prot., datë 17.07.2024 me objekt “Dërgim vendimi per procedurën e prokurimit me objekt “Blrje kancelari dhe bojra printeri””, autoriteti kontraktor ka dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik vendimin ku konstatohet, se e ka pranuar pjesërisht atë, si më poshtë:

[...]*2.3 Kapaciteti teknik 1. Ne shtojcen nr.6 nuk është percaktuar grafiku/afati i levrimit. Ju lutemi te percaktohet afati/grafiku levrimit. Nisur nga sasia e produkteve, vleresome se nje afat 15ditor eshte mese I mjaftueshem per te realizuar proceduren, duke patur parasysh që procedura zhvillohet ne mes te sezonit veror, ku nje pjese e stafit marrin lejen e zakonshme.

• **Kerkesa pranohet**, afati i levrimit te mallit do te ndryshoje dhe do bëhet 10 dite, me argumentimin se eshte nje afat i mjaftueshem per paragitjen e ketyre mallrave, kancelari dhe bojera printeri.

*. Tonerat te kene afat skadence jo me pak se nje vit nga momenti i levrimit te mallit, (në momentin e dorezimit te mallit tek autoritetit kontraktor, malli te shoqërohet me certifikaten e garancise).

• **Kerkesa pranohet, dhe behet ndryshimi si me poshte** : • Tonerat duhet te jene te reja, te paperdorura, te ambaiazhuara ne kuti dhe të plotesone te gjithë elementet e sigurise, ne rastet kur aplikohen nga prodhuesi.

**Artikulli nr.21 Color LazerJet Pro M254dë eshte printer me ngiyre, me 4 tonera. Njësia e vendosur nga AK ishte Cope 1. Ju lutemi specifikoni se cilën ngiyre doni te prokuroni.

• **Kjo kerkesë pranohet**, artikulli nr.21 Color LazerJet Pro M254dw eshte printer me kater ngjyra,te katerta ngjyrat.[...]

III.1.3. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

Për këtë arsye, KPP do të mbyllë shqyrtimin e çështjes në lidhje me këto pjesë të pranuar nga autoriteti kontraktor për ankesat me nr. 1857 dhe 1889 prot, datë 10.07.2024 dhe 08.07.2024 të operatorëve ekonomikë “Blueprint Technologies” SHPK; dhe “Infosoft Office” SHPK. Autoriteti kontraktor nuk ka ngarkuar shtojcën me ndryshimet përkatëse. Komisioni sjell në vëmendje publikimin e tyre.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Infosoft Office” SHPK dhe “Blueprint Technologies” SHPK, ku kërkon :

Infosoft Office-

Kërkesat e mësipërme janë të ekzagjerura dhe jo në përputhje dhe në proporcion me vlerën dhe objektin e prokurimit. AK-ja ka kërkuar mostra për të gjithë artikujt tonera dhe katalogë apo skeda teknike për të gjithë artiuajt e tjerë të kancelarisë apo të shtypshkrimeve dhe kjo është një kërkesë e ekzagjeruar pasi në total janë 69 lloje artikuj kancelarisë, 6 llojeve të shtypshkrimeve dhe 21 llojet e tonerave të cilat një pjesë e madhe e tyre janë kërkuar në sasi të vogla. E konkretisht: Në rastin e tonerave për të gjitha llojet e kërkuara për tu prokuruar sasi të për secilën prej tyre janë më pak se 9 copë dhe pjesa më e madhe e tyre janë ekërkuar në sasi deri në 5 copë. Është ekzagjeruar të kërkuar mostra për tonera të cilat janë kërkuar 1, apo 2, 3, 4 apo edhe 5 copë. Kriteri 2.3.4 të behet 2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi të cilat janë me përdorim më të lartë në institucion, artikujt e kancelarisë të kërkuar nga AK-ja, në sasi të barabartë ose më lartë se 500 copë duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave ose mostra të tyre, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike ose mostra duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. 2.3.4 për artikujt e ofertuar (bojerat e printerit) të kërkuar nga AK-ja në sasi mbi 5 copë, duhet të paraqiten mostrat origjinale/ekuivalente, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave.

Blueprint technologies-

Në piken 2.3.4 Kapaciteti teknike kërkohej dorezimi i mostrave për të gjithë produktet tonera. Kërkesa nuk është proporcionale me madhësinë/peshën që secili toner zë në procedurë, pasi një pjesë e mirë e tonerave kërkohej të prokurohen në 1-3 cope. Vleresojme se do të ishte një kërkesë e argumentuar, paraqitja e mostrave për tonerat me përdorim më të madh, konkretisht : Artikulli nr.3 Phaser 3260/WorkCentre xerox 3215/3225 Standard Capacity Black Genuin Toner Cartridge, 1500 flete Artikulli nr.9 Lexmark MB2236 adw DRAM Artikulli nr. 11 Lexmark MB 2236 adw toner Artikulli nr.15 Printer Lexmark MS 621 Artikulli nr.20 Xerox 3025/3020

III.2.1 Autoriteti Kontraktor, në shtojcën 7 të DST, ka përcaktuar kriterin 2.3.4, si më poshtë vijon:

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues për mallrat objekt prokurimi duhet të paraqesë katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve ose skedat teknike të mallrave objekt prokurimi, me qëllim vërtetimin e përmbushjes së specifikimeve teknike. Katalogu ose skeda teknike duhet të përmbajë karakteristikat teknike të çdo artikulli sipas kërkesave të DST me qëllim që autoriteti kontraktor të gjykojë nëse malli i ofruar plotëson kërkesat teknike të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Për produktet e thjeshta për të cilat nuk mund të sigurohen katalogë ose skeda teknike mjafton të paraqiten mostrat sipas parashikimeve në pikën 2.3.4 dhe ky kriter do të konsiderohet i përmbushur.

2.3.4 Për artikujt e ofertuar (bojerat e printerit) duhet të paraqiten mostrat origjinale/ekuivalente, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues.

III.2.2 Autoriteti Kontraktor, në shtojcën 5 të DST, ka përcaktuar specifikimet teknike si më poshtë vijon:

Specifikimet Bojra :

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

BOJRA			
NR.	Artikujt	Njësia	Sasia
1	Brother TN2210, TN2250 (Brother HL2250) Original Toner Cartridge	cope	3
2	DRAM Brother TN2210, TN2250 (Brother HL2250)	cope	1
3	Phaser 3260/WorkCentre xerox 3215/3225 Standard Capacity Black Genuin Toner Cartridge, 1500 flete	cope	8
4	DRAM WorkCentre xerox 3225	cope	1
5	Bizhub 40P Toner	cope	2
6	HP 2420 11A, HP2410 Black Genuine Toner Cartridge, 12000 pages	cope	2
7	HP Deskejt F2420, 600 pages, 440 pages 1 x Black and 1 x Colour Cartridge (all high capacity)	cope	1
8	Xerox 5335 Toner black	cope	1
9	Lexmark MB2236 adw DRAM	cope	4
10	Xerox 5335 DRAM	cope	1
11	Lexmark MB 2236 adw toner	cope	5

12	XeroxVersaLink C7025 original set Black/Cyan/Magenta/Yellow	cope	2
13	HP 1160 toner	cope	2
14	Printer Samsung Xpress M20236	cope	3
15	Printer Lexmark MS 621	cope	9
16	Printer Laser jet Pro M203 dw	cope	3
17	Printer Hp laser jet 1018	cope	3
18	Fotokopje Toshiba Estudio 167	cope	3
19	Printer Kyocera TASKalfa 2200	cope	3
20	Xerox 3025/3020	cope	9
21	Color LazerJet Pro M254dw	cope	1

1. Tonerat duhet të jenë bojra origjinale ose kompatibël, të shoqëruar me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura. Tonerat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të ambalazuara në kuti dhe të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë.
2. Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako.
3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara (numrit të printimeve).
4. Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/numrin e printimeve/kodin e tonerit dhe nëse tonerat janë kompatibël duhet të kenë të shënuar mbi kuti që janë kompatibël për modelin e printerit.
5. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me çertifikatën e garancisë).
6. Operatori ekonomik do të marrë përsipër ndërrimin e çdo toneri që mund të ketë difekt fabrike ose që nuk përshtatet me paisjen.

III.2.3 Neni 2, “Qëllimi i ligjit” 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Neni 3 “*Parime të përgjithshme*”: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën. I

II.2.4 Neni 21, “*Autoriteti ose enti kontraktor*”: 1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.

III.2.5 Referuar pretendmeve të operatoreve ekonomikë ankimues, të paraqitura në ankesat e tyre, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se është me vend të ndalet në faktin nëse kërkesa për paraqitjen e mostrave për secilin prej artikujve është në proporcion me objektin e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 77 pika 1 të LPP-së. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertuese zotërojnë kapacitetet e nevojshme për realizimin e kontratës. KPP konstaton, se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit jo vetëm kritere kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e kapacitetit teknik, por edhe kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen me vërtetimin e plotësimit të specifikimeve teknike të produktit me anë të dorëzimit të mostrave. Në këto kushte, KPP gjykon, se kërkesa e mësipërme, *Për artikujt e ofertuar (bojerat e printerit) duhet të paraqiten mostrat origjinale/ekuivalente, sipas specifikimeve teknike në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mosdorëzimi i këtyre mostrave në kohë përbën shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik ofertues.*, është kërkesë që shkon përtej asaj çka është e nevojshme për përmbushjen e synimit pasi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit, kritere të tjera kualifikimi të cilat lidhen plotësisht me specifikimeve teknike të produktit, siç është kërkesa për katalog, dhe për sa i përket artikullit toner ekziston një katalog lidhur me këtë produkt ndaj, Komisioni i Prokurimit Publik për sa i përket kriterit të përcaktuar nga vetë autoriteti kontraktor, gjykon se disponimi i një mostre lidhur me këtë artikull është i panevojshëm për sa kohë kërkohet katalogu lidhur me këtë produkt, ku me anë të saj kryhet dhe verifikimi i përcaktimeve të specifikimeve teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor dhe specifikimeve teknike të katalogut të artikullit.

Sa më sipër, pretendimet e operatoreve ekonomikë ankimues “Infosoft office” dhe “Blue Print Technologies” SHPK, qëndrojnë:

III.3 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Blueprint Technologies” SHPK ku kërkon: *Pika 2.2.2 Kriteret e Veçanta të Kualifikimit kërkon: operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt ekspertizën e Ekspertit kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar, (i ndryshuar). Procedura objekt ankimi është procedure E hapur e Thjeshtuar. Për këto procedura, LPP dhe VKM për RPP parashikon se Kriteret ekonomike financiare duhet të jene të thjeshtuara, dhe këto të fundit provohen me paraqitjen e vërtetimit të xhiros për 3 vitet e fundit. (neni 55 pika 4 I VKM 285 date 19.05.2021). Per sa me sipër, kerkojme qe kjo kerkese te hiqet.*

III 3.1. Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti ekonomik dhe financiar” pika 2.2.2 dhe 2.2.1 ka parashikuar si më poshtë:

2.2.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë një vërtetim nga autoriteti përgjegjës për xhiron vjetore të realizuar në tre vitet e fundit ushtrimore 2021, 2022, 2023, vlera mesatare e të cilës duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e fondit limit pa TVSH.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin Nr.10091, datë 05.03.2009 ”Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, (i ndryshuar).

Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

III.3.2. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit”, 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“Qëllimi i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik”.*

III.3.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të*

padrejtë operatorë ekonomike të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën”.

III.3.4 Në nenin 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se: *“1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi”.*

III.3.5 Në nenin 43, “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiare”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare .*

2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar

b) vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar; c) 40 % të vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në procedurat e prokurimit “Shërbim konsulence”.

3. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

4. Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit . 5. Në rastin e kontratave që bazohen në një marrëveshje kuadër, kërkesa për xhiron minimale, llogaritet mbi bazën e vlerës maksimale të kontratave specifike që do të zbatohen në të njëjtën kohë ose, kur përmasat nuk dihen, mbi bazën e vlerës së parashikuar të marrëveshjes kuadër. 6. Në çdo rast, kërkesat e mësipërme duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës. Ato i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës

III.3.6. Në nenin 55 “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, pika 4 e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“[...]Në këtë lloj procedure prokurimi, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në konsideratë të përcaktuara kritere të thjeshtuara pranimit, me*

qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkojnë në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave...[...]”

III.3.7. KPP gjykon, se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret KPP konstaton, se synimi bazë i autoritetit kontraktor është vërtetimi se subjektet ofertues zotërojnë kapacitetet e ekonomike të nevojshme për realizimin e kontratës. Në këtë kuadër KPP, vëren se për përmbushjen e këtij synimi, autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentet e procedurës së prokurimit krahas paraqitjes nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës të mundshëm, kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, ka kërkuar dhe **bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023** Sa më sipër, referuar llojit të procedurës së prokurimit e konkretisht “*procedurë e hapur e thjeshtuar*”, legjislacioni parashikon që autoritet/entitet kontraktore duhet të përcaktojnë kriteret të thjeshtuara pranimi, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe pjesëmarrjes së biznesit të vogël dhe të mesëm. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në frymën e ligjit, duhet të marrë masa për të hequr kriterin e kërkesës së dorëzimit të kopjeve të bilanceve të certifikuar, që plotësimi i këtyre kërkesave të mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4 Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik “Blue Print technologies” SHPK se:

2- Ne shtojcën nr.5 Formulari I Specifikimeve Teknike, në tabelen ku pasqyrohen produktet dhe sasia e tyre, për pjesën me të madhe të tonerave është kërkuar që tonerat duhet të jenë detyrimisht origjinale të prodhuesit të printerit (Genuine). Gjithashtu për të gjithë tonerat është përcaktuar marka e tonerit, pa vendosur në ose ekuivalente sic kërkojnë nga LPP dhe aktet nenligjore në zbatim të tij. Në mbështetje të LPP dhe VKM për RPP AK duhet të pranojë oferta me tonera ekuivalente me origjinalin, të prodhuara nga kompani të ndryshme nga kompania që ka prodhuar printerin. Për sa më sipër, kërkojmë nga AK të editojë tabelen në shtojcën 5, duke shtuar togfjalëshin ose ekuivalente për çdo produkt

III.4.1 . Në shtojcën 5 “*Formulari i specifikimeve teknike*”, të dokumenteve të tenderit përcaktohet:

Specifikimet Bojra :

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

BOJRA			
NR.	Artikujt	Njësia	Sasia
1	Brother TN2210, TN2250 (Brother HL2250) Original Toner Cartridge	cope	3
2	DRAM Brother TN2210, TN2250 (Brother HL2250)	cope	1
3	Phaser 3260/WorkCentre xerox 3215/3225 Standard Capacity Black Genuin Toner Cartridge, 1500 flete	cope	8
4	DRAM WorkCentre xerox 3225	cope	1
5	Bizhub 40P Toner	cope	2
6	HP 2420 11A, HP2410 Black Genuine Toner Cartridge, 12000 pages	cope	2
7	HP Deskejt F2420, 600 pages, 440 pages 1 x Black and 1 x Colour Cartridge (all high capacity)	cope	1
8	Xerox 5335 Toner black	cope	1
9	Lexmark MB2236 adw DRAM	cope	4
10	Xerox 5335 DRAM	cope	1
11	Lexmark MB 2236 adw toner	cope	5

12	XeroxVersaLink C7025 original set Black/Cyan/Magenta/Yellow	cope	2
13	HP 1160 toner	cope	2
14	Printer Samsung Xpress M20236	cope	3
15	Printer Lexmark MS 621	cope	9
16	Printer Laser jet Pro M203 dw	cope	3
17	Printer Hp laser jet 1018	cope	3
18	Fotokopje Toshiba Estudio 167	cope	3
19	Printer Kyocera TASKalfa 2200	cope	3
20	Xerox 3025/3020	cope	9
21	Color LazerJet Pro M254dw	cope	1

1. Tonerat duhet të jenë bojra origjinale ose kompatibël, të shoqëruar me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura. Tonerat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të ambalazuara në kuti dhe të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë.
2. Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako.
3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara (numrit të printimeve).
4. Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/numrin e printimeve/kodin e tonerit dhe nëse tonerat janë kompatibël duhet të kenë të shënuar mbi kuti që janë kompatibël për modelin e printerit.
5. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me çertifikatën e garancisë).
6. Operatori ekonomik do të marrë përsipër ndërrimin e çdo toneri që mund të ketë difekt fabrike ose që nuk përshtatet me paisjen.

III.4.2 Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”

Ndërkohë në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.4.3. Në nenin 4 “Përkufizime” të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *Ekuiivalente*” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit.

III.4.4. Neni 21 pika 1 “Autoriteti ose enti kontraktor” i ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: *Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj.*

III.4.5. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuara ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. *Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

3. *Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:*

a) *kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;*

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës "a", referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës "b" të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët "ose ekuivalenti i tij/saj".

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët "ose ekuivalente".

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "b" të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës "a" të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor."

III.4.6. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së *lex specialis*, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse, duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar, se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor, edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore, nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtar apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet

kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt.

Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP-ja gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet, si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t'u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështetet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionale sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt- kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët **“ose ekuivalenti i tij/saj”**. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrencë të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: *“Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohet në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim”*. Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet *“Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t'u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për sigurim të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për pranim të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t'i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të*

kufizuar dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.”

Ndërsa, në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: *“specifikim teknik”* nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni Europian vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: *“Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.”*

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim që nuk janë në përpjesëtim me natyrën dhe objektin e procedurave të prokurimit publik është kufizuese dhe çon drejt një prodhuesit të vetëm. Përcaktimi i kriterëve nga autoriteti kontraktor duhet t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë por njëkohësisht duhet të vlerësohet sipas një diapazoni të arsyeshëm dhe proporcional për realizimin e kontratës, me qëllim hapjen e konkurrencës. Pretendimi i operatorit ekonomik për shtimin e termit “ekuivalent” për sa i përket produkteve tonera është i mirëargumentuar dhe i mbështetur në ligj.

Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Referuar sa më sipër, KPP e gjen të drejtë pretendimin e operatorit ekonomik “Blue Print Technologies” SHPK. KPP gjykon, se sikundër parashikon edhe ligji “Ekuivalente” është malli ose shërbimi i ofruar me karakteristika të barasvlefshme me ato që janë përcaktuar në specifikimin teknik të objektit të prokurimit. Në këtë kuptim KPP gjykon, se kërkesa e autoritetit kontraktor për toner pa përcaktuar një term ekuivalent nuk është vendosur në përputhje me përcaktimet ligjore, të cilat detyrojnë autoritetin kontraktor të mos referojë drejt një prodhuesi ose një marke të caktuar apo në rastin që e bën këtë të përdorë domosdoshmërisht frazën ekuivalent. Për rrjedhojë KPP gjykon, se duhet të modifikohet nga autoriteti kontraktor, duke përcaktuar edhe termin ekuivalent sikurse përcaktohet në nenin 36 të LPP, në mënyrë që të shmangët çdolloj konfuzioni gjatë dorëzimit të ofertave nga ana e operatorëve ekonomikë të interesuar për pjesëmarrje apo akoma më tej edhe për të lehtësuar punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave gjatë fazës së vlerësimit të ofertave.

Për sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Blue Print Technologies” SHPK qëndrojnë.

III.5 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Blue Print Technologies” SHPK dhe “Infosoft Office” SHPK se

BluePrint Techonologies SHPK : pika 2 e shtojces 5, kerkon: emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako. Te gjitha kerkesat e mesiperme kane te bejne me elemente dizajni/paketimi te cilet nuk ndikojne ne funksionalitetin e produktit. Gjithashtu, menyra se si prodhuesi paketon apo emerton produktin e tij, nuk perben element skualifikues. Gjithashtu jo te gjithë prodhuesit perdorin numra seriale per produktet e tyre, dhe aq me teper ti vendosin ato ne te gjitha vendet e kerkuara. Per sa me siper, kerkojme qe kjo kerkese te hiqet. Infosoft Office SHPK

Ëmri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako...

II.5.1. Në shtojcën mbi specifikimet teknike të tonerave autoriteti kontraktor ka përcaktuar disa kërkesa si me poshtë vijon:

III.5.1 . Në shtojcën e publikuar lidhur me tonerat “Formulari i specifikimeve teknike”, të dokumenteve të tenderit lidhur me tonerat përcaktohet:

Specifikimet Bojra :

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

BOJRA			
NR.	Artikujt	Njësia	Sasia
1	Brother TN2210, TN2250 (Brother HL2250) Original Toner Cartridge	cope	3
2	DRAM Brother TN2210, TN2250 (Brother HL2250)	cope	1
3	Phaser 3260/WorkCentre xerox 3215/3225 Standard Capacity Black Genuin Toner Cartridge, 1500 flete	cope	8
4	DRAM WorkCentre xerox 3225	cope	1
5	Bizhub 40P Toner	cope	2
6	HP 2420 11A, HP2410 Black Genuine Toner Cartridge, 12000 pages	cope	2
7	HP Deskejt F2420, 600 pages, 440 pages 1 x Black and 1 x Colour Cartridge (all high capacity)	cope	1
8	Xerox 5335 Toner black	cope	1
9	Lexmark MB2236 adw DRAM	cope	4
10	Xerox 5335 DRAM	cope	1
11	Lexmark MB 2236 adw toner	cope	5

12	XeroxVersaLink C7025 original set Black/Cyan/Magenta/Yellow	cope	2
13	HP 1160 toner	cope	2
14	Printer Samsung Xpress M20236	cope	3
15	Printer Lexmark MS 621	cope	9
16	Printer Laser jet Pro M203 dw	cope	3
17	Printer Hp laser jet 1018	cope	3
18	Fotokopje Toshiba Estudio 167	cope	3
19	Printer Kyocera TASKalfa 2200	cope	3
20	Xerox 3025/3020	cope	9
21	Color LazerJet Pro M254dw	cope	1

1. Tonerat duhet të jenë bojra origjinale ose kompatibël, të shoqëruar me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura. Tonerat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të ambalazuara në kuti dhe të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë.
2. Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako.
3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara (numrit të printimeve).
4. Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/numrin e printimeve/kodin e tonerit dhe nëse tonerat janë kompatibël duhet të kenë të shënuar mbi kuti që janë kompatibël për modelin e printerit.
5. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me çertifikatën e garancisë).
6. Operatori ekonomik do të marrë përsipër ndërrimin e çdo toneri që mund të ketë difekt fabrike ose që nuk përshtatet me paisjen.

III.5.3 Neni 2 “Qëllimi i ligjit” 162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikon se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit

publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.5.3 . Neni 3 “Parime të përgjithshme”: 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën

III.5.5. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” *1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi*

III.5.6. Në nenin 44 “Kërkesat e cilësisë”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit. 2. Kur autoriteti/enti kontraktor prokuron punë, furnizime ose shërbime me karakteristika specifike mjedisore, sociale ose të tjera, në specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e kontratës fituese ose në kushtet për zbatimin e kontratës, mund të kërkojë një etiketë specifike si një mënyrë për të vërtetuar se punët, shërbimet ose furnizimet përkojnë me karakteristikat e kërkuara, në përputhje me nenin 37, të LPP-së. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit. 3. Certifikatat dhe etiketat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, si dhe çdo operator ekonomik duhet të ketë akses në to, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit. 4. Nëse autoriteti/enti kontraktor kërkojnë një certifikatë, ose etiketë, ata janë të detyruar të pranojnë çdo certifikatë ose etiketë ekuivalente/ të barasvlershme me të, ose një dokument që provon të njëjtin informacion. 5. Kur është e dukshme që një operator ekonomik e ka të pamundur të marrë etiketën specifike, të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor ose një etiketë ekuivalente, brenda afateve kohore përkatëse, për shkaqe që nuk lidhen me atë operator ekonomik, autoriteti ose enti kontraktor pranon mënyra të tjera vërtetimi të përshtatshme, që mund të përfshijnë një dosje teknike nga prodhuesi, nëse operatori ekonomik në fjalë vërteton se punët, furnizimet ose shërbimet që ai*

duhet të ofrojnë përmbushin kërkesat e etiketës specifike ose kërkesat specifike të cilësuar nga autoriteti/enti kontraktor.

III.5.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se është e nevojshme të ndalet në një interpretim të zgjeruar të dispozitës së lex specialis, mbi mënyrën e hartimit të specifikimeve teknike. Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se autoritetet kontraktore në hartimin e specifikimeve teknike, krahas përshkrimit të saktë të nevojave të këtij të fundit, duhet të kenë në vëmendje faktin, se hartimi i specifikimeve teknike duhet bërë në një mënyrë gjithëpërfshirëse duke krijuar kushte për konkurrin të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve, duke përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë karakteristikat e mallrave/shërbimeve/punëve dhe në përputhshmëri me objektin e kontratës. Për këtë qëllim ligjvënësi ka parashikuar se këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Ligjvënësi ka parashikuar qartësisht në nenin 36 pika 1 paragrafi 4 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, se duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik. Në respekt të parimit të mësipërm, specifikimet teknike, në asnjë rast nuk duhet të diskriminojnë/përrjashtojnë nga konkurrimi operatorët ekonomikë ofertues dhe/ose prodhuesit qofshin këta kombëtarë apo ndërkombëtarë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo formë diskriminimi, qoftë ato të dukshme, qoftë ato të fshehta, të cilat kanë të njëjtin efekt. Në asnjë rast, specifikimet teknike nuk duhet të hartohen në mënyrë që të drejtojnë drejt një produkti/malli/shërbimi, që ofrohen nga një operator i vetëm ekonomik ose nga një prodhues i vetëm. KPP gjykon, se parashikimet e mësipërme duhet të zbatohen në të gjithë procedurat e prokurimit, me përjashtim të rasteve ku vetë ligji i prokurimit publik, parashikon një përjashtim të tillë. Në hartimin e specifikimeve teknike autoritetet kontraktore duhet të mbajnë në vëmendje faktin, se specifikimet teknike duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP dhe që i vlerëson punët/mallrat/shërbimet si të pranueshme për funksionet e kërkuara. Gjithashtu, duke u ndalur në pikën 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, KPP-ja gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar katër metoda kryesore në hartimin e specifikimeve teknike. Metoda e parë lidhet me kërkesat funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën. Metoda e dytë mbështet në standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve. Metoda e tretë përfshin kërkesat në termat funksionalë sipas metodës së parë, por referuar specifikimeve teknike të hartuara sipas metodës së dytë, si një

mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale, si edhe të të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të nenit 36 të ligjit për prokurimin publik, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Në hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe në dokumentet e tenderit. Nga interpretimi teleologjik (qëllimi i normës juridike), arrijmë në përfundim, se e rëndësishme është që përmes specifikimeve teknike, autoriteti kontraktor të mundësojë një konkurrim të drejtë, të hapur, e gjithëpërfshirës, të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, si edhe të mos drejtohen drejt një produkti të vetëm të ofruar nga një operator i vetëm ose nga një numër i kufizuar operatorësh ekonomikë. Gjithashtu, referuar nenit 42 të Direktivës 24/2014 “Për prokurimin publik” KE, parashikohet se: “Specifikimet teknike siç përcaktohen në pikën 1 të Shtojca VII do të përcaktohen në dokumentet e prokurimit. Specifikimi teknik përcakton karakteristikat, që kërkohen për një punë, shërbim ose furnizim” Gjithashtu, në nenin 4 paragrafi 38 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” përcaktohet “Specifikime teknike” janë: a) në rast të prokurimit publik të punëve, përmbledhje e të dhënave teknike të përfshira në dokumentacionin e tenderit, me të cilat janë përkufizuar karakteristikat e nevojshme të materialeve, prodhimeve ose mallrave për t’u përshtatur me përdorimin që i duhet autoritetit ose entit kontraktor. Këto karakteristika përfshijnë ndikimin mbi mjedisin jetësor dhe ndikime klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe procedurat për siguri të cilësisë, terminologjinë, simbolet, metodat e testimit, paketimit, shënimit dhe etiketimit, si dhe udhëzime për shfrytëzim, proceset dhe metodat e prodhimit të objektit. Gjithashtu, këto karakteristika, përfshijnë rregulla nga projekti dhe rregulla për vlerësim të shpenzimeve, kushte për testim, për inspektim dhe për praninë të punëve të realizuara, metoda ose teknika ndërtimore, si dhe të gjitha kushtet e tjera teknike, të cilat autoriteti ose enti kontraktor ka të drejtë t’i përcaktojë në pajtim me rregullat e përgjithshme dhe të veçanta në lidhje me objektin dhe materialet ose pjesët e përfshira; b) në rast të prokurimit publik të mallrave ose shërbimeve, specifikimi me të cilin përkufizohen karakteristikat e prodhimit ose shërbimit, siç janë niveli i cilësisë, ndikimi mbi mjedisin jetësor dhe ndikimet klimatike, përshkrim i të gjitha kushteve, duke përfshirë edhe arritshmëri për persona me aftësi të kufizuara dhe vlerësim të përputhshmërisë, niveli i realizimit, shfrytëzim i prodhimit, siguri ose dimensione, duke i përfshirë edhe kërkesat relevante për produktin në raport me emërtimin me të cilin shitet, terminologjinë, simbolet, testimet dhe metodat për testim, paketimin, shënimin dhe etiketimin, si dhe udhëzime për përdorim, proceset dhe metodat e prodhimit në secilën fazë të jetëgjatësisë së mallrave dhe shërbimeve, si dhe procedura për vlerësim të përputhshmërisë.” Në pikën 1 të Shtojcës VII të Direktivës parashikohet se: "specifikim teknik" nënkupton njërin nga sa vijon: b) në rastin e kontratave të furnizimit publik ose shërbimeve, një specifikim në një dokument që përcakton karakteristikat e kërkuara të një produkti ose një shërbimi, siç janë nivelet e cilësisë, nivelet e performancës mjedisore dhe klimatike, modelimi për të gjithë kërkesat (përfshirë aksesin e personave me aftësi të kufizuara) dhe vlerësimin e konformitetit, performancën, përdorimin e tyre produkti, siguria ose dimensionet, përfshirë kërkesat që lidhen me produktin në lidhje me emrin nën të cilin produkti shitet, terminologji, simbole, metodat e provës dhe provës, paketimin, markimin dhe etiketimin, përdorues-udhëzimet, proceset e prodhimit dhe metodat në çdo fazë të ciklit jetësor të furnizimit ose shërbimit dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit; Në vendimin e GJED Çështja C-368/10 “Komisioni

European vs. Mbretëria e Holandës” inter allia dhe mutatis mutandis është arsyetuar se: “Specifikimet teknike të hartuara nga blerësit publik duhet të lejojnë që prokurimet publike të hapen në konkurrencë. Për këtë qëllim, duhet të jetë e mundur të dorëzohen tenderë që pasqyrojnë larminë e zgjidhjeve teknike. Prandaj, duhet të jetë e mundur të hartohen specifikimet teknike për sa i përket performancës funksionale dhe kushteve, dhe kur referimi bëhet në standardin Evropian ose, në mungesë të tij, ndaj standardit kombëtar, ofertuesit bazuar në marrëveshje ekuivalente duhet të merren në konsideratë nga autoritetet kontraktuese.” Gjithashtu, nga ana tjetër Komisioni i Prokurimit Publik gjen me vend të sqarojë, se është në të drejtë të operatorëve ekonomikë, që në respekt të nenit 109 e vijues të ligjit nr.162/2020 ”Për prokurimin publik”, të parashirojnë pretendime mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit përfshirë edhe specifikimet teknike të procedurës, brenda afatit të përcaktuar në nenin 110 pika 1 të ligjit. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se ligji 162/2020 ”Për prokurimin publik” 30 është përafuar pjesërisht edhe me Direktivën e Këshillit 89/665/KEE, datë 21 dhjetor 1989 “Mbi koordinimin e ligjeve, rregulloreve dhe dispozitave administrative në lidhje me zbatimin e procedurave të rishikimit për dhënien e kontratave të furnizimit publik dhe punëve publike”, e ndryshuar”. Numri CELEX 31989L0665, Fletorja Zyrtare e Bashkimit European, Seria L, nr.395, datë 30.12.1989, fq. 33. Në dritën e direktivës, ekzistojnë dy kushte të përmendura në lidhje me qasjen në procedurat e rishikimit (neni 1 (3): "Procedurat e rishikimit duhet të jenë në dispozicion (...) të paktën për çdo person që ka ose ka pasur interes për të marrë një kontratë të veçantë dhe që ka qenë ose rrezikon të dëmtohet nga një shkelje e pretenduar". Në interpretim literal, sistematik dhe teologjik me synim vendosjen në pah të ratio legis, mbështetur edhe në parimin e së drejtës se ratio legis est anima legis, (qëllimi i ligjit është edhe shpirti i ligjit), interesi i ligjshëm i operatorëve për të paraqitur ankim pranë autoritetit kontraktor si edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik duhet të jetë dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i marrë nga autoriteti kontraktor në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik. KPP thekson, se fakti se një ose disa produkte të një ose disa prodhuesve vendas ose ndërkombëtarë nuk përmbushin minimumin e specifikimeve teknike të përcaktuara nga ana e autoritetit kontraktor, nuk përbën një kusht sine qua non, se specifikimet teknike janë hartuar në kundërshtim me ligjin për prokurimin publik. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi në kuptimin klasik të barrës së provës referuar parimit juridik onus probandi incubit actor (barra e provës i bie kërkuesit), si edhe në përputhje me nenin 82 pika 1 të ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në të cilin parashikohet se: “në procedurat administrative, të filluara me kërkesë të palës që inicion procedurën, barra e provës për faktet e pretenduara bie mbi këtë palë, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”. Pra, operatorët ekonomikë duhet të argumentojnë/dëshmojnë, se specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik dhe jo mbi faktin, se këto të fundit nuk plotësohen nga një ose disa prodhues kombëtarë/ndërkombëtarë me reputacion. Nga ana tjetër, Komisioni i Prokurimit Publik, nënvizon, se autoriteti kontraktor në hartimin e specifikimeve teknike të procedurës së prokurimit duhet t’i përmbahet stricto-sensu vetëm metodave të parashikuara në nenin 36 të ligjit për prokurimin publik.

III.5.7. KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik, si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjithë palët në proces.

III.5.8. Referuar rastit konkret, KPP gjykon, se specifikimi teknik për artikullin toner, i përcaktuar nga autoriteti kontraktor *“Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako”*, nuk është i përshtatshëm për arritjen e synimit të autoritetit kontraktor, për verifikimin e përputhshmërisë së produkteve, kjo pasi plotësimi i kërkesave së mësipërme varet nga vullneti i prodhuesve dhe jo i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës për hartimin dhe dorëzimin e ofertave në përputhje me kërkesën e autoritetit kontraktor. Në rastin konkret, me të drejtë ankimuesi kundërshton kërkesat lidhur me pamjen e produktit, që nuk kanë lidhje me funksionalitetin e tij dhe plotësimi i tyre është në diskrecion të vetë prodhuesit dhe jo të ofertuesve pjesëmarrës në procedurë. Kërkesat që tonerat të kenë *Emrin e kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët* kufizojnë ata prodhues që elementet e kërkuar lidhur me produktin, mund t’i kenë të pasqyruara në trupin e produktit dhe jo domosdoshmërisht në ambalazhin e tyre, apo që ambalazhimin e produktit e kanë në forma të tjera. Në këto kushte, Komisioni gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kërkesat e mësipërme, duke lënë të hapur mundësinë e vendosjes së kërkesave në fjalë, qoftë në ambalazhin e produktit ashtu edhe në trupin e tij, si dhe mënyrën e ambalazhimit të produktit, mjafton që elementet që provojnë përputhshmërinë e produktit të ofruar me atë të kërkuar të jenë të pasqyruara në të. Modifikimi i kriterit është i nevojshëm në rastin konkret, për të shmangur çdolloj konfuzioni në radhët e operatorëve ekonomikë mbi mënyrën e përmbushjes së tij dhe njëherazi për të lehtësuar punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave.

Sa më sipër pretendimet e ankimuesve qëndrojnë

III.6 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Blue Print Technologies” SHPK se *Pika 3 e Shtojces 5 kërkon: operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara (numrit të printimeve). Nderkohe që AK nuk ka përcaktuar kapacitetin e tonerave në tabelën e shtojces 5. Kapaciteti i kërkuar është përcaktuar për disa nga tonerat, por mungon për pjesën me të madhe të tyre.*

Per sa me sipër, kërkojme që AK të plotësojë kapacitetin për secilin toner.

III.6.1 . KPP-ja gjykon, se vetë ligjvënësi ka parashikuar në nenin 2 gërma “dh” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, se qëllimi i ligjit të prokurimit publik si ligj material i zbatueshëm për shqyrtimin administrativ të ankesave të operatorëve ekonomikë, është ndër të tjera të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik. Ashtu si edhe GJED ka nënvizuar ndër vite, parimi i transparencës dhe barazisë janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën, por detyra thelbësore e transparencës në një procedurë prokurimi është që të krijohen kushte dhe rregulla të hollësishme për të gjitha palët në proces.

III.6.2 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se në rastin konkret ndodhemi para kërimit për sqarime mbi specifikimet/ kërkesat në procedurën e mësipërme të prokurimit dhe në këtë kuadër objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimes nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se projekti apo specifikimi teknik/ apo kriteri është në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimin publik), por në thelb janë paqartësi mbi kërkesën e sipërpërmendur. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 75 të LPP-së, i cili parashikon shprehimisht se: *“Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti ose enti kontraktor, i cili duhet t’i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 6 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor ose enti duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t’ua komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit.*

Në çdo rast, sqarimi i dokumenteve të tenderit nuk do të konsiderohet shtim, pakësim ose ndryshim i kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit”. Referuar sa me lart, autoriteti kontraktor nuk ka kthyer përgjigje lidhur me këtë pikë në shkresën e depozituar pranë KPP me nr. 616 prot., datë 15.07.2024, protokolluar me tonën nr. 1857/2, datë 17.07.2024. KPP gjykon, që autoriteti kontraktor të kryejë një unifikim të kërkesës së mësipërme me ato në tabelën e publikuar me specifikime teknike lidhur me tonerat dhe të japë sqarime lidhur me to. Akoma me tej, lidhur me kërkesat për sqarim, Komisioni sjell në vëmendje, se këto sqarime duhet të publikohen në sistemin e prokurimit elektronik, në përputhje me përcaktimet e nenit 75 të LPP-së.

III.7 Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Blue Print technologies” SHPK me pretendimin se :

1- *Ne kundërshtim me ligjin e prokurimeve Autoriteti kontraktor ka përfshirë në një procedurë prokurimi 2 kategori produktesh që nuk kanë ngjashmëri teknike. Kancelaria dhe Tonerat/pjesët e kembimit të printerave nuk kanë asnjë element të prebashket. Ka shumë kompani që tregetojnë vetëm tonera dhe pjesë kembimi për printera, sic ka dhe shumë*

kompani qe jane te specializuara ne kancelari. Ne perputhje me ligjin e prokurimeve, per te garantuar perdorimin sa me eficient te fondeve publike, si dhe per te garantuar barazine ne tendera midis OE Kerkojme nga ana juaj ndarjen e kesaj procedure ne 2 lote [...]Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.2. Në dokumentet e tenderit, Shtojca 5, “Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit”, autoriteti kontraktor ka përcaktuar:

Specifikime Kancelari :

A	SHTYPSHKRIME	
1	Liber korespodence (protokolli) me kapak kartoni 43x30 cm	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
2	Leter karton indikator shumengjyreshe 15x50 mm 4x40sheet, jo plastike	Leterkarton indikator shumengjyreshe 15x50 mm 4x40sheet, jo plastike
3	Liber magazine 25 cm L40cm 500 flete	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
4	Blloqe dore te vogla A5 me vija ,me kapak te trashe	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
5	Blloqe per lexues matesi (sipas modelit) ,100 flete	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
6	Liber marrje dhe dorezim sherbimi,100 flete	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
B	KANCELARI	
1	Dosje arkivi me buton ose llastik 25x35x12 cm	Dosje me buton, material karton i plastifikuar. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentat. Duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat 34-36cm x 24-26cm x 14-16cm.
2	Dosje kartoni te thjeshta me vesh nga brenda	Kjo dosje të jetë prej kartoni me mundësi shkrimi në kapakun e saj. Të jetë minimumi me 3 lembe. Përmasat 34-36cm x 24-26cm.
3	Dosje arkivi me buton ose llastik 25x35x5 cm	Kjo dosje të jetë prej kartoni të plastifikuar e cila shërben për të mbrojtur dhe ruajtur dokumentat. Mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për të lëvizur lehtësisht. Të jetë minimumi me 3 lembe. Përmasat 34-36cm x 24-26cm x 4-5cm.

4	Kuti arkivi 40x28x18 cm me kapak	Dosje me buton, material karton i plastifikuar. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentat. Duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat 34-36cm x 24-26cm x 14-16cm.
5	Dosje arkivi 25x35x16	Dosje me buton, material karton i plastifikuar. Kjo dosje me buton shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentat. Duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Përmasat 34-36cm x 24-26cm x 14-16cm.
6	Bllloqe flete dalje vetekopjuese A5 me tre kopje me kapak kartoni	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
7	Bllloqe flete hyrje vetekopjuese A5 me tre kopje me kapak kartoni	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
8	Bllloqe fleteporosi A5 me me kapak kartoni	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
9	Dosje kartoni me mekanizem 8/32cm	Kjo dosje me mekanizem shërben për të mbrojtur dhe ruajtur të gjitha dokumentet duke i kapur me mekanizëm. Kjo dosje duhet të ketë dhe kuti që shërben për të qëndruar sa më mirë në raft. Ajo duhet të ketë një mekanizëm metalik, i cili i mban dokumentat të mbërthyer me anë të dy shufrave dopjo në të cilat vendosen letrat A4 pasi janë hapur vrimat përkatëse me hapëse vrimash dopjo ose beset mbajtëse përkatëse. Gjithashtu, duhet të ketë një etiketë për identifikim të lehtë të kontekstit të dokumenteve përbërëse. Materiali të jetë karton i presuar dhe i plastifikuar. Të mbajë minimumi 600 fletë A4 me gramature 80gm ² . Përmasat 32-34cm x 28-30cm x 7-9cm.
10	Boje tamponi blu	Boje ngjyre Blu per te gjitha llojet e vulave. Te jete boje cilesore dhe shume rezistente. Paketimi ne shishe plastike jo me pak se 20ml.
11	Stilolaps trup trekendor blu	Stilolaps me boje ngjyre blu i tipit ballpoint me maje 0.5mm - 0.8mm. Te mos krijoje ngecje apo rrjedhje boje gjate shkrimit.
12	Stilolaps trup trekendor i I kuq	Stilolaps me boje ngjyre te kuqe i tipit ballpoint me maje 0.5mm - 0.8mm. Te mos krijoje ngecje apo rrjedhje boje gjate shkrimit.
13	Boje korektuese stilolapsi	Boje e bardhe korektues per stilolaps.

14	Lapsa HB me gome	Lapsi prej grafiti to jete i prodhuar nga materiale sintetike, qe do te thote se nuk leshon cifla ne rast se thyhet, si dhe te jete rezistent ndaj shtypjes dhe perdorimit. Shkalla e grafitit te jete minimumi HB.
15	Zarfa me leter te bardhe me ngjites 23x33 cm	Zarf prej letre per postim. Ngjyra e bardhe. Te jete i mbyllur nga tre and dhe me ngjitje nga ana e hapur. Permasat 23cm x 33cm.
16	Zarfa me leter te bardhe me ngjites 19x26 cm	Zarf prej letre per postim. Ngjyra e bardhe. Te jete i mbyllur nga tre ane dhe me ngjitje nga ana e hapur. Permasat 19cm x 26cm.
17	Zarfa me leter te bardhe me ngjites 11x23 cm	Zarf prej letre per postim. Ngjyra e bardhe. Te jete i mbyllur nga tre ane dhe me ngjitje nga ana e hapur. Permasat 11cm x 23cm.
18	Zarfa plastik (zelatin) me vrime anesore 100cope/pako	Pako me 100 qese plastike prej materiali polipropilen, transparente dhe me madhesi A4, me spesor jo me pak se 100 mikron. Keto qese mund te perdoren me te gjitha llojet e lidhasve te unazave si nje menyre per te mbrojtur dhe renditur dokumentet. cdo qese te kete kapacitet mbajtes jo me pak se 40 flete A4 80gm2 secila.
19	Fletore shkrimi me vija spiral 80 fleteshe	Fletore Shkrimi me vija
20	Fletore katrore spiral 80 fleteshe	Fletore katrore
21	Vizore 30 cm plastike	Vizore me gjatesi 30-50 cm prej materiali metalik dhe rezistent qe nuk thyhet.
22	Fallcet zyre metalike 18mm	Fallcet zyre metalike 18mm
23	Lama 18mm 10cope/pako	Lama 18mm 10cope/pako
24	Gome fshirese e bardhe me zatore	Game universale per fshirje lapsi dhe boje. Te jete e bere nga materiali gome e bute (jo PVC), e pershtatshme per te fshire dhe njollat me te theksuara te lapsit dhe bojës. Nuk duhet te lere shenja dhe grimca ne flete pas perdorimit.
25	Tusha nenshkrimi shume ngjyreshe	Evidenciator (highlighter). Evidenciatori te kete nje maje te petezuar e cila ndihmon per nenvijezime ose evidentime. Te kete ngjyre te hapur (jo te erret dhe te mundesoje shikimin lirshem te shkrimit ne dokumente pasi vijezohet mbi te), e cila thahet menjehere. Maja e vijezimit te jete minimumi 5mm.

26	Bllloqe shenimi tavoline me ngjyra 500 flete me ngjites	Bllloqe me ngjitje 75mm±5mm x 75mm±5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjitese sherbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj.
27	Bllloqe shenimi leter stik me ngjitje 100 flete	Bllloqe me ngjitje 75mm±5mm x 75mm±5mm me 50 flete me ngjyra te ndryshme. Letrat ngjitese sherbejne per te nxjerre ne pah mesazhet e rendesishme dhe ngjiten edhe mbi siperfaqe te veshtira. Ato mend te perdoren per te shenuar lajmerime,shenime etj.
28	Tela makine 24/6	Kapeset/tela te jene te dizajnuara me material te cilesise se larte, te galvanizuar dhe te jene parashikuar per te shpuar paster permes fleteve te shumta te letrës pa u keputur ose shqyer letren. Te jene prej metali te kromuar ose te pandryshkshem. Paketimi jo me pak se 1000 cope.
29	Laps Portamin 1mm	Të jetë me kokë të rikthyeshme për të mbrojtur majën e minave. Të jetë i ndërtuar me anë të sistemit të ushqimit të majave që lejon shkrimin pa ndërprerje me mina 1mm HB ose 2HB.
30	Maja portamine 1mm	Maja 1mm HB ose 2HB. Gjatësia e minave 4-6cm. Paketimi të ketë minimumi 40 copë.
31	Laps Portamin 0.7 mm	Të jetë me kokë të rikthyeshme për të mbrojtur majën e minave. Të jetë i ndërtuar me anë të sistemit të ushqimit të majave që lejon shkrimin pa ndërprerje me mina 0.7mm HB ose 2HB.
32	Maja portamin 0.7 mm	Maja 0.7mm HB ose 2HB. Gjatësia e minave 4-6cm. Paketimi të ketë minimumi 40 copë.

33	Laps portamin 0.5 mm	Të jetë me kokë të rikthyeshme për të mbrojtur majën e minave. Të jetë i ndërtuar me anë të sistemit të ushqimit të majave që lejon shkrimin pa ndërprerje me mina 0.7mm HB ose 2HB.
34	Maja portamin 0.5 mm	Maja 0.5mm HB ose 2HB. Gjatësia e minave 4-6cm. Paketimi të ketë minimumi 40 copë.
35	USB 16 GB	UPS
36	Kapse letrë forme (s) 77mm 100cope/pako	Kapese dokumentash ne forme "U", 77 mm. Te jete ideale per te kapur letra apo dokumente te ndryshme ne zyre, shkolle etj. Te jete e ndertuar me material çeliku te qendrushem. Paketimi ne pako me jo me pak se 100 cope kapese.

37	Kapese letre forme (s) 50mm 100cope/pako	Kapese dokumentash ne forme "U", 50 mm. Te jete ideale per te kapur letra apo dokumente te ndryshme ne zyre, shkolle etj. Te jete e ndertuar me material çeliku te qendrueshem. Paketimi ne pako me jo me pak se 100 cope kapese.
38	Kapese letre forme (s) 32mm 100cope/pako	Kapese dokumentash ne forme "U", 32 mm. Te jete ideale per te kapur letra apo dokumente te ndryshme ne zyre, shkolle etj. Te jete e ndertuar me material çeliku te qendrueshem. Paketimi ne pako me jo me pak se 100 cope kapese.
39	Kapese letre forme (s) 28mm 100cope/pako	Kapese dokumentash ne forme "U", 28 mm. Te jete ideale per te kapur letra apo dokumente te ndryshme ne zyre, shkolle etj. Te jete e ndertuar me material çeliku te qendrueshem. Paketimi ne pako me jo me pak se 100 cope kapese.
40	Vinovil stick 20gr	Vinovil stick 20gr
41	Leter ngjitese e tejdkushme me bazment	Leter ngjitese e tejdkushme me bazment
42	Leter ngjitese e tejdkushme 50x65	Leter ngjitese e tejdkushme 50x65
43	Leter ngjitese e tejdkushme 18x25 mm	Leter ngjitese e tejdkushme 18x25 mm
44	Bateri alkaline 1.5 V AAA	Bateri alkaline 1.5 V AAA
45	Kapese me vesh (binder clips) 24 mm 12cope/pako	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Paketimi jo më pak se 12 copë.
46	Kapese me vesh (binder clips) 32 mm	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Paketimi jo më pak se 12 copë.
47	Kapese me vesh (binder clips) te medha 10cope/pako	Ndërtimi i produktit të jetë i fortë dhe i qëndrueshëm që lejon të kapen shumë faqe së bashku për organizimin përfundimtar të dokumentave. Paketimi jo më pak se 12 copë.
48	Prefse maja lapsi metalike	Mprehes lapsash me dy vrima dhe me depozite per ashklat e mprehura. Per lapsa deri ne 11 mm dhe kend mprehes te ndryshem. Thikat e mprehjes te jene metalike te kromuara ose metal i pandryshkshem.
49	Mekanizem per heqjen e lelave te makinave kapse	Heqese për tela/kapëse ne forme pince e perbere nga material metalik. Te heqe te gjitha llojet e telave standarte. Te jete e pershtatshme per perdorim zyre.

50	Libreza per arketim detyrimesh uji	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
51	Leter A4	<p>Letrat të jenë ekselente. Të kenë ngjyrë të bardhë. Të jenë shumë përdorimshe. Letra duhet te jete cilesi e pare dhe të plotësojë standartet ISO 9001 ose ekuivalenti i tij. Pështa e nje fije jo më pak se 80 gr/m² dhe nje rizme (500 fije x A4). Permasat te jene 210x 297 cm. Lëmueshmëri: 80-120 ml/min.</p> <p>Multifunkionale- per fotokopje, printer, faks. Lagështira: ≤ 5 %. Trashësia ≥ 100µm. Drita: ≥ 95%. Shkelqimi: ≥ 95%. Amballazhimi; Mbeshtjellje kunder lageshtires dhe kuti me kapacitet 5 rizma. Letra te mos bllokoje makinën fotokopjuese apo printerin, fax-in. Te qendroje e rrafshet pas printimit apo fotokopjimit. Te mos leshoje pluhur letre pas printimit apo fotokopjimit. Te jete e pershtatshme per printim ne te dyja anet. Te plotesoje standartet qe letra te mbahet per kohe te gjate ne arkive sipas Standartit Shqiptar SSH EN ISO 9706:2002 ose ekuivalenti i tij. Te mos jete e ricikluar.</p>
52	Stilolapsa tush (pilot gel) per firmosje blu ose ekuivalent , Rapidograf	Stilolapsa tush (pilot gel) per firmosje blu ose ekuivalent , Rapidograf
53	Mbajtese kancelarie (Kaset per vendosje kapsash shumekendeshe)	Mbajtese kancelarie, me set i cili perbehet minimumi nga 12 produkte. Ne kete set duhet te perfshihen minimalisht keto produkte: mbajtesja e intullueshme e kancelarive, laps, stilolaps, gershere, vizore, prefese lapsi, kapse letrash. Mbajtesja te jete prej materiali plastik. Preferohet ngjyre e erret.
54	Makine kapse metalike EXPERT 24/6	Makina per kapse aktesh (Stapler), te jete metalike dhe me material çelik i pandryshkshëm ose i kromuar ne forme pince. Makina te jete pershtatshme per te kapur minimalisht 45 flete te gramatures 80 gr/m ² . Gjithashtu ajo duhet to kapi dhe me pak fleta ne varesi te perdorimit duke nderruar numrin e telave. Te perdoret me tela/kapese 24/6, 26/6, 26/8 dhe 24/8.
55	Gershere letre mesatare	Gershere letre mesatare
56	Dosje konferenciale magnetike A5 zeze	Dosje konferenciale magnetike A5 zeze
57	Dosje konferenciale A4 me kapse metalike	Dosje konferenciale A4 me kapse metalike

58	Makina Llogaritese 12 shifra (208x163x40)	Makine llogaritese tavoline me jo me pak se 12 shifra te shfaqura ne ekran. Të kete ekran te madh me pjerresi te rregullueshme dhe burim energjie me bateri dhe diellore. Me opsion Tax+ dhe Tax-, po ashtu edhe me opsion per kembimin valutor. Zgjedhje rumbullakimi dhe presje dhjetore. Fikje automatike.
59	Leter ngjitese (tenie) per amballazh	Leter ngjitese (tenie) per amballazh
60	Dosje me qese plastike 40 zarfa	Dosje me qese plastike 40 zarfa
61	Mandat arketimi 3 kopje	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
62	Mandat pagese	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
63	Tela 23/8	Kapeset/tela te jene te dizajnuara me material te cilesise se larte dhe te galvanizuar, te jene parashikuar per to shpuar paster permes fleteve te shumta te letres pa u keputur ose shqyer letren. Paketimi jo me pak se 1000 cope.
64	Zarf me pieta A4	Zarf me pieta A4
65	Dosje me llastik(shume ngjyrshë)	Kjo dosje të jetë prej kartoni të plastifikuar e cila shërben për të mbrojtur dhe ruajtur dokumentat. Mbyllet me ndihmën e një llastiku, në mënyrë që të ruajë sa më mirë materialet në brendësi si dhe për të lëvizur lehtësisht. Të jetë minimumi me 3 lembe. Përmasat 34-36cm x 24-26cm.
66	Leter A3	Letrat të jenë ekselente. Të kenë ngjyrë të bardhë. Të jenë shumë përdorimshe. Letra duhet te jete cilesi e pare dhe të plotësojë standartet ISO 9001 ose ekuivalenti i tij. Peshë e nje fije jo më pak se 80 gr/m ² dhe një rizmë (500 fije x A3). Përmasat te jene 297mm x 420mm. Lemueshmeri: 80-120 ml/min. Multifunksionale - per fotokopje, printer, faks. Lagështira: ≤ 5 %. Trashësia ≥,100µm. Drita: ≥ 95%. Shkelqimi: ≥ 95%. Amballazhimi; Mbeshtjellje kunder lageshtires dhe kuti me kapacitet 5 risma. Letra te mos bllokoje makinen fotokopjuese apo printerin, fax-in. Te qendroje e rrafshet pas printimit apo fotokopjimit. Te mos leshoje pluhur letrë pas printimit apo fotokopjimit. Te jete e pershtatshme per printim ne te dyja anet. Te plotesoje standartet qe letra te mbahet per kohe te gjate ne arkive sipas Standartit Shqiptar SSH EN ISO 9706:2002 ose ekuivalenti i tij. Te mos

		jete e ricikluar.
67	Leter kase 80x60 mm	Do te prodhohen sipas modeleve qe do te vihen ne dispozicion nga autoriteti kontraktor.
68	Makine kapse metalike (me diapazon 23/6 deri 2324	Makine kapse aktesh prej materiali metalik. Makina te jete pershtatshme per te kapur minimalisht 200 flete te gramatures 80 gr/m2. Gjithashtu ajo duhet to kape dhe me pak fleta ne varesi te perdorimit duke nderruar numrin e telave. Te kete depozite per te vendosur telat. Çdo informacion shtese per numrin e telave qe perdoren ne varesi te fletave duhet te jene to shpjeguara dhe ne trup to produktit. Telat te jene nga 23/6 deri 23/24.
69	Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm	Flamur me thek (institucioni) 90x145 cm

Në shtojcën e publikuar lidhur me tonerat “*Formulari i specifikimeve teknike*”, të dokumenteve të tenderit lidhur me tonerat përcaktohet:

Specifikimet Bojra :

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

BOJRA			
NR.	Artikujt	Njësia	Sasia
1	Brother TN2210, TN2250 (Brother HL2250) Original Toner Cartridge	cope	3
2	DRAM Brother TN2210, TN2250 (Brother HL 2250)	cope	1
3	Phaser 3260/WorkCentre xerox 3215/3225 Standard Capacity Black Genuin Toner Cartridge, 1500 flete	cope	8
4	DRAM WorkCentre xerox 3225	cope	1
5	Bizhub 40P Toner	cope	2
6	HP 2420 11A, HP2410 Black Genuine Toner Cartridge, 12000 pages	cope	2
7	HP Deskjet F2420, 600 pages, 440 pages 1 x Black and 1 x Colour Cartridge (all high capacity)	cope	1
8	Xerox 5335 Toner black	cope	1
9	Lexmark MB2236 adw DRAM	cope	4
10	Xerox 5335 DRAM	cope	1
11	Lexmark MB 2236 adw toner	cope	5

12	XeroxVersaLink C7025 original set Black/Cyan/Magenta/Yellow	cope	2
13	HP 1160 toner	cope	2
14	Printer Samsung Xpress M20236	cope	3
15	Printer Lexmark MS 621	cope	9
16	Printer Laser jet Pro M203 dw	cope	3
17	Printer Hp laser jet 1018	cope	3
18	Fotokopje Toshiba Estudio 167	cope	3
19	Printer Kyocera TASKalfa 2200	cope	3
20	Xerox 3025/3020	cope	9
21	Color LazerJet Pro M254dw	cope	1

1. Tonerat duhet të jenë bojra origjinale ose kompatibël, të shoqëruar me pullë sigurie, të pahapura dhe jo të rimbushura. Tonerat duhet të jenë të reja, të papërdorura, të ambalazuara në kuti dhe të plotësojnë të gjithë elementet e sigurisë.
2. Emri i kompanisë prodhuese duhet të jetë i stampuar dhe i njëjtë në paketim, cartridge (toner). Marka prodhuese të jetë në ambalazhin dhe/ose në trupin e tonerave, numrat serialë të tonerave duhet të korrespondojnë në të gjitha pjesët e trupit, në pako.
3. Operatori ekonomik duhet të deklarojë se tonerat janë sipas kapaciteteve të kërkuara (numrit të printimeve).
4. Në momentin e lëvrimit të mallit çdo produkt duhet të ketë të etiketuar qartë prodhuesin, modelin/numrin e printimeve/kodin e tonerit dhe nëse tonerat janë kompatibël duhet të kenë të shënuar mbi kuti që janë kompatibël për modelin e printerit.
5. Tonerat të kenë afat skadence jo më pak se një vit nga momenti i lëvrimit të mallit, (në momentin e dorëzimit të mallit tek autoritetit kontraktor, malli të shoqërohet me certifikatën e garancisë).
6. Operatori ekonomik do të marrë përsipër ndërrimin e çdo toneri që mund të ketë difekt fabrike ose që nuk përshtatet me paisjen.

III.7.2. Neni 2 “Qëllimi i ligjit “162/2021 “Për prokurimin publik”, parashikon se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Neni 39 i ligjit“162/2021 “Për prokurimin publik” parashikon se:

Autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë të japë një kontratë në formën e loteve të veçanta, duke përcaktuar madhësinë dhe objektin e këtyre loteve.

Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

2. Autoriteti ose enti kontraktor përcakton në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi ose kur thirrja për konkurrim bëhet përmes njoftimit për ekzistencën e një sistemi kualifikimi, në ftesën për ofertë ose për të negociuar, nëse ofertat mund të dorëzohen për një, për disa ose për të gjitha lotet.

Edhe kur ofertat mund të dorëzohen për disa ose të gjitha lotet, autoriteti ose enti kontraktor mund të kufizojë numrin e loteve që mund t'i jepen një ofertuesi, nëse numri maksimal i loteve për ofertues deklarohet në njoftimin e kontratës, në ftesën për shprehje interesi, në ftesën për ofertë ose në ftesën për të negociuar.

Kur zbatimi i kriterëve për shpalljen e kontratës fituese do të bënte që një ofertues të shpallej fitues i më shumë loteve sesa numri maksimal, autoriteti ose enti kontraktor përcakton në dokumentet e tenderit kriteret objektive dhe jodiskriminuese ose rregullat që synojnë të zbatojnë për të përcaktuar lotet që do të jepen.

- 1. Kur të njëjtit ofertues mund t'i jepet më shumë se një lot, autoriteti ose enti kontraktor mund të japë kontrata që kombinojnë disa ose të gjitha lotet, pasi të kenë specifikuar në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi mundësinë për ta bërë këtë, dhe lotet ose grupet e loteve që mund të kombinohen.*

Në nenin 42, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

- 1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.*
- 2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektorial*

III.2.4.Nga shqyrtimi i dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt - ankimi, KPP konstaton, se objekti i këtij prokurimi është blerja nga ana e autoritetit kontraktor, e mallrave të tilla si: kancelari shtypshkrime tonera. KPP vëren, se mallrat objekt - prokurimi janë tonera për printerë dhe pajisje kancelarie, ku tonerat zënë një pjesë të konsiderueshme të preventivit. Referuar parashtrimeve në ankesë rezulton, se ankimesi kërkon ndarjen në lote të procedurës së prokurimit, pasi kancelaria dhe tonerat nuk kanë asnjë element të përbashkët. Ka shumë kompani që tregtojnë vetëm tonera, sikurse ka dhe shumë të tjera të specializuara në kancelari. Komisioni i Prokurimit Publik thekson, se ndarja ose jo, e një kontrate në lote, është një vendim i rëndësishëm që autoriteti kontraktor merr gjatë procesit paraprak të prokurimit, pasi ndikon drejtpërdrejtë në nivelin e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në këtë procedurë prokurimi. Kjo bëhet duke mbajtur në konsideratë elemente të tilla si: tregu, konkurrenca e mundshme, vlera e prokurimit, kostot e ekzekutimit të kontratës dhe vështirësia teknike lidhur me ndarjen në lote etj., dhe veçanërisht faktin nëse objekti i kontratës është një punë/shërbim/mall për të cilin ofertuesit janë të paktë. KPP vlerëson, se mosndarja në lote e procedurës së prokurimit në rastin konkret, ul konkurrencën në radhët e operatorëve ekonomikë dhe nuk stimulon pjesëmarrjen e biznesit të vogël. Në këtë kuptim, KPP gjykon, se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për ndarjen e procedurës në lote, në respekt të parimit të barazisë, të nxitjes së pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; si dhe nxitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve ekonomikë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30 dhe pikat 1 dhe 2 të nenit 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar të ankesave të operatorëve ekonomikë “Infsoft Office” SHPK, “BluePrint Technologies”, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-12189-07-04-2024, me objekt: “Blerje kancelari dhe bojëra printeri”, me fond limit 1,620,870.00 lekë (pa TVSh), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 16.07.2024 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Sarandë SH.A.
 2. Të pranojë ankesat e operatorëve ekonomikë “Infsoft Office” SHPK, “Blue Print Technologies” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe të publikojë të gjitha ndryshimet në Sistemin Elektronik të Prokurimeve.
 4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 5. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorët ekonomikë “Infsoft Office” SHPK, “Blue Print Technologies” SHPK.
 6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë.
 7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

